



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Nr. Nisja Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	1502
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	2	Data Datum Date:	07-28-17
		PRISHTINË/A	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**  
**Ministria e Zhvillimit Ekonomik**  
**Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development**

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, në mbështetje të nenit 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 Tetor 2010), nenin 8 paragrafi 1.4. të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MZHE) Nr. 01/2017 për promovimin e investimeve të përbashkëta rajonale në sektorin e energjisë (GZ 08.03.2017), nxjerr:


**V E N D I M**

1. Divizioni për Standarde dhe Rregulla Teknike në kuadër të Departamentit të Energjisë, caktohet si Autoritet Kompetent (One Stop Shop) për bashkërendimin e aktiviteteve në lëshimin e lejeve për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë.
2. Divizioni për Standarde dhe Rregulla Teknike (One Stop Shop), sipas pikës 1 të këtij Vendimi është përgjegjës për:
  - 2.1. lehtësimin dhe bashkërendimin e procesit të dhënies së lejeve për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë;
  - 2.2. bashkëpunimin me autoritetet tjera kompetente si dhe me palët tjera kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në përgatitjen e planeve të përbashkëta me qëllim të koordinimit të afateve;
  - 2.3. publikimin dhe përditësimin, kurdo që është e nevojshme të Doracakut Procedural sipas nevojës në bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse që japin leje;
  - 2.4. modifikimin e konceptit të pjesëmarrjes publike, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, dorëzuar nga promovuesi i projektit.
  - 2.5. përgatitjen e skemës së hollësishme të afateve për procesin e dhënies së lejeve, në konsultim me promovuesin e projektit dhe autoritetet tjera të përfshira;
  - 2.6. përgatitjen e raportit të progresit të arritur në planifikimin dhe zhvillimin e projekteve me interes për Komunitetin e Energjisë, si dhe sipas nevojës të dorëzojë ato raporte tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë; si dhe,
  - 2.7. çështje tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

3. Obligohet Divizioni për Standarde dhe Rregulla Teknike/Departamenti i Energjisë për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Blerand Stavileci

  
Ministër i Zhvillimit Ekonomik

Iu dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Energjisë;
- Arkivës.

Prishtinë, 26.07.2017